

BASHKIA FIER

Adresa : Lagja "Kastriot", Rruga "Brigada e XI Sulmuese"; Tel/Fax : 034 410 636; www.bashkiafier.gov.al

Nr. _____ Prot.

Datë 07/03/2016

KONTRATE SIPERMARRJE- Nr.5/231/2016 ME OBJEKT :

**"Rikonstruksion i rruges dhe rehabilitim i fasadave te rruges Mujo
Ulqinaku"**

Drejtuar : _____

PALËT :

- ❖ AUTORITETI KONTRAKTOR : BASHKIA FIER
- ❖ KONTRAKTOR : SHOQËRIA "AGBES KONSTRUKSION" SHPK FIER



KONTRATE SIPERMARRJE Nr. 3/231/2016

“Rikonstruksion i rruges dhe rehabilitim i fasadave te rruges Mujo Ulqinaku”

Lidhur sot, më 07/03/2016 midis Bashkise Fier, perfaqesuar nga Kryetari i Bashkise z.Armando SUBASHI nga njera ane dhe bashkimit te perkohshem te shoqerive “Agbes Konstruksion” shpk Fier, me perfaqesues ligjor te tyre z.Arben GOGA nga ana tjetere, te quajtur perkatesisht ketu e me poshte, Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Kontraktori.

PERKUFIZIME:

1. **“Kontrate”** do te thote Kontrate Sipermarrije nr.5/231/2016, me permbajtje dhe termat ne tekstin si me poshte. **“Kontratë”** do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkengjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
2. **“Vlefte e Kontrates”** eshte vlefte e plote ne leke perfshi TVSH e fituar ne tenderin e dates 01.02.2016 te organizuar ne Bashkine Fier per ndertimin e ketij Objekti.
3. **“Objekt”** do te thote **“Rikonstruksion i rruges dhe rehabilitim i fasadave te rruges Mujo Ulqinaku”** Fier, Shqiperi, sipas Projektit te miratuar dhe Preventivit e Specifikimeve teknike te dhena e te pranuar ne tender.
4. **“Autoriteti Kontraktor”** eshte **BASHKIA FIER**.
5. **“Kontraktor”** eshte shoqeria “Agbes Konstruksion” shpk Fier, me numer NIPT-it K32807432W.
6. **“Preventiv”** do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje. Volumet dhe cmimet per secilin ze jane pjese e Ofertes Fituese dhe pjese e kesaj kontrate.
7. **“Situacion Pjesor”** do te thote situacioni per nje pjese te punimeve te preventivit, ku percaktohen zerat, volumet me matje, cmimet e fituar ne tender, vlefte e tyre, TVSH-ja dhe Vlefte me TVSH.
8. **“Situacion Perfundimtar”** do te thote situacioni per punimet e plota te percaktuara ne preventiv, ku percaktohen zerat, volumet me matje, cmimet e fituar ne tender, vlefte e tyre, TVSH-ja dhe Vlefte me TVSH, brenda vleres se fituar ne tender.
9. **“Data e kryerjes se plote”** do te thote data qe ndertimet duhet te mbarohen sic eshte shprehur ne grafikun per kryerjen e Ndertimeve.
10. **“Kryerja”** do te thote data e vertetuar se Ndertimet jane mbaruar.
11. **“Difekt”** do te thote cdo pjese e ndertimeve e parealizuar ne perputhje me specifikimet teknike te kontrates.
12. **“Data e hyrjes”** do te thote data qe Autoriteti Kontraktor lejon Kontraktorin ne Objekt dhe marrjen prej tij ne dorezim te Sheshit te Ndertimit me proces-verbal.
13. **“Materiale”** do te quhen te gjitha furnizimet duke perfshire edhe ato te konsumueshme, cilesia e te cilave vertetohet me certifikate, te perdorura nga Kontraktori per trupezimin e tyre ne ndertimin e objektit.
14. **“Standarte Teknike”** do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit
15. **“Mbikqyresi i punimeve”** (Supervizori) do te thote subjekt fizik/juridik i lecsuar me te cilin AK ka lidhur Kontrate Mbikqyrje per ndertimin e Objektit. Detyrat dhe pergjegjesisite e tij jane percaktuar ne U.K.M. nr. 3 date 15.02.2001 “Per Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve te Ndertimit” te ndryshuar, U.K.M. Nr.2 date 13.05.2005 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit” dhe paraqiten ne Kontraten e Mbikqyrjes.
16. **“Kolaudatori”** do te thote subjekt fizik/juridik i lecsuar me te cilin AK ka lidhur Kontrate per Kolaudimin e Objektit. Detyrat dhe pergjegjesisite e tij jane percaktuar ne U.K.M. nr. 3 date 15.02.2001 “Per Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve te Ndertimit” te ndryshuar dhe paraqiten ne Kontraten e Kolaudimit.
17. **“Ndertime”** do te thote Projekt i Zbatimit dhe Preventivi i Zbatimit, pjese perberese e Kontrates.
18. **“Llogaritja e afateve”** Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.
19. **“Afati i Garancise se Punimeve”** do te thote periudha prej 24 muaj e cila fillon nga data e aktit te kolaudimit te punimeve, gjate te ciles Kontraktori riparon me shpenzimet e tij cdo difekt qe ka ardhur si pasoje e cilesise se punimeve te kryer prej tij.
20. **“Garancia e Punimeve”**, eshte vlera prej 5% e vlefes se situacionit perfundimtar te miratuar.



- 21. "Baza ligjore" Kontrata do t'i nenshtrohet, do te qeveriset dhe do te interpretohet sipas ligjeve dhe dispozitave nenligjore ne fuqi te Republikes se Shqiperise, perfs hire te gjitha dokumentat e tenderit dhe te ofertes se Kontraktorit te cilat jane pjese e kesaj kontrate sipas permbajtjes se tyre.
- 22. "Force Madhore" do te thote nje ngjarje qe nuk mund te kontrollohet nga palet, ku perfs hihen, por nuk jane te limitizuara, lufta, revolucionet, zjarri permytja, termeti, epidemite, karantina, embargo tranziti, etj.

I. OBJEKTII KONTRATES

"Rikonstruksion i rruges dhe rehabilitim i fasadave te rruges Mujo Ulqinaku", sipas Projektit, Preventivit te miratuar me zera e volume dhe specifikimeve teknike te pranuar ne tender te cilat jane pjese perberese e kesaj kontrate dhe perbejne detyrim ligjor per zbatim nga palet ne kete kontrate.

II. VLEFTA DHE AFATI I KONTRATES

Vlefte e fituar ne tender per perfundimin e punimeve ne total eshte me TVSH 237 591 722 lekë (dyqind e tridhjete e shtate million e peseqind e nentedhjete e nje mije e shtateqind e njezet e dy), dhe afati i kryerjes se punimeve eshte 6 (gjashte) muaj.

Ne baze te shkreses nga Ministria e Financave, Drejtoria e Menaxhimit te Buxhetit me nr.14880/2 prot., dt.04.11.2015 "Per akordimin e fondit nga Fondi per Zhvillimin e Rajoneve vendimi nr.39, dt16.10.2015", kontraktohet me vlere te plote, por per vitin 2016 do te financohet ne vleren 157 550 739 (njeqind e pesedhjete e shtate milion e peseqind e pesedhjete mije e shtateqind e tridhjete e nente) leke me TVSH, pjesa tjeter do te financohet ne vitin 2017, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.


Kontraktori eshte i detyruar te perfundoje te gjitha punimet (volumet e parashikuara ne preventiv) sipas afateve te zbatimit te punimeve dhe konform specifikimeve teknike dhe standarteve perkatese pavaresisht financimit. Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

Ne vlefte totale te mesiperme perfs hihet TVSH, si dhe te gjitha detyrimet e tjera fiskale ne Republiken e Shqiperise.

III. TE DREJTAT DHE DETYRAT E AK

- 1. Te njohe zyrtarisht Kontraktorin me Mbikqyresin, Kolaudatorin, si dhe t'i dorezoj atij nga nje kopje te Kontrates se Mbikqyrjes dhe Kontrates se Kolaudimit. Nga ana e Bashkise Fier do te vendoset nepermjet procedures se prokurimit, si perfaqesues prane sipermarresit, mbikqyresin e punimeve.
- 2. Te marre te gjitha masat per gatitore per lirimin e Sheshit te Ndertimit dhe te lejoj Kontraktorin te hyj ne Objekt dhe ta dorezoj ate me proces-verbal ne prani te Mbikqyresit.
- 3. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës dhe Kontraktorit i lind e drejta të kërkoje amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. *Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.* (Neni 18 i KPP tek DST)
- 4. Brenda Dates se Hyrjes te siguroj te gjitha lejet e nevojshme ligjore ne menyre qe t'i krijoj kushte pune normale Kontraktorit.
- 5. Te miratoj Situacionin Pjesor dhe Sitacionin Perfundimtar te paraqitur e te miratuar nga Mbikqyresi.
- 6. Te asistoj ne procesin e kolaudimit perfundimtar te Objektiv.
- 7. Ka te drejte qe per te realizuar me se miri anen funksionale te Objektiv, te beje ndryshime jo thelbesore ne Projektin e Zbatimit dhe ne Preventivin e Zbatimit/ Ndertimet shtese mund te porositen vetem ne rrethana te percaktuar ne LPP dhe U.K.M. Nr.2 date 13.05.2005 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit" dhe me kusht qe shtesa e kontrates te mos i kaloje 20% te cmimit origjinal te kontrates.
- 8. Autoriteti Kontraktor ne çdo kohe, mund te porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e mëposhtëm (neni 36.3 i KPK ne DST):
 - a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
 - b) Korrigjime në materiale
 - c) Korrigjime në sasi

A



- 9. Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materilizojë amendamentet e marreveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marreveshjes.
 - 10. Te marre ne dorezim Objektin pas kolaudimit perfundimtar.
 - 11. Te vëri ne shfrytezim Objektin dhe pas përfundimit te Afatit te Garancise te leshoje Certifikaten e garancise se punimeve.
 - 12. Te Verifikoje kryerjen e riparimit te difekteve te ndodhura dhe per ato qe nuk jane eliminuar llogarit koston e ndreqjes se tyre dhe bene ndalesen nga vlefte e Garancise se Punimeve.
 - 13. Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
 - a) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë;
 - b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
- Autoriteti Kontraktor duhet t'i japë kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim të detyrimeve dhe kushteve të kontratës për një afat 15 ditë të plotë kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

III. TE DREJTAT DHE DETYRAT E KONTRAKTORIT (SIPERMARRESIT)

- 1. Te siguroj Kontraten ne vleren 10% te vlefes totale te kontrates para lidhjes se saj. Sigurimi i Kontrates te behet ne formen e Garancise Bankare ose Siguracion ne nje nga shoqerite e sigurimeve te licensuara.
- 2. Kontraktori eshte i detyruar te siguroje prane shoqerive te sigurimit, nga Data e hyrjes ne objekt deri ne Afatin e Mbarimit të punimeve, te gjitha elementet e percaktuar ne piken 6.1 te Shtojces 18 te DST, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
- 3. Te marre ne dorezim Objektin duke reflektuar ne proces-verbalin perkates gjendjen teknike te tij.
- 4. **Data e fillimit te punimeve eshte data e marrjes se Objektit (sheshit te ndertimit) ne dorezim dhe emerimit te mbikeqyresit te punimeve nga AK.**
- 5. Menjëherë pas lidhjes së kontratës, Kontraktori duhet t'i paraqesë mbikqyresit të punimeve një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve.
- 6. Te caktoj drejtuesin/it teknik te tij ne perputhje me licencen e paraqitur ne tender, te cilet do te drejtojne te gjitha punimet per zbatimin e Projektit te Zbatimit dhe te njoftoj zyrtarisht Mbikqyresin e punimeve dhe AK, duke paraqitur edhe dokumentacionet ligjore te tij/tyre.
- 7. Te njohe, te respektoj termat e Kontrates te Mbikqyrjes dhe Kontrates se Kolaudimit dhe t'i krijoj kushte normale pune Mbikqyresit dhe Kolaudatorit.
- 8. Te realizoj Projektin e Zbatimit ne perputhje me Specifikimet Teknike dhe t'i perfundoj punimet ne perputhje me volumet e punes per cdo ze te preventivuar per jo me shume se **6 muaj**.
- 9. Te pranoje cdo ndryshim jo thelbesor te miratuar nga Investitori ne Projektin e Zbatimit dhe ne Preventivin e Zbatimit brenda vleres se Kontrates.
- 10. Gjate kryerjes se punimeve, te njoftoj ne kohe dhe zyrtarisht Investitorin per ato raste te mosperputhjes se Projektit te Zbatimit dhe te Preventivit te Zbatimit. Deri ne paraqitjen zyrtare te qendrimin te Investitorit per ceshtjet e ngritura, Sipermarresi duhet te nderprese (pezulloje) punimet.
- 11. Periudha e nderprerjes se punimeve duhet te pasqyrohet ne Proces-Verbalin perkates dhe te vertetohet nga Mbikqyresi i punimeve. Periudha e nderprerjes te punimeve per arsyet e shprehura ne piken 9 te kapitullit IV, merret ne konsiderate per llogaritjen e afatit te përfundimit të punimeve, duke shtyre afatin e dorezimit të punimeve për atë kohë sa zgjat ndërprerja e punimeve.
- 12. Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se Kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktori duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkaku dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori.
- 13. Te siguroje vete transportin, makinerite, fuqine puntore, drejtimin teknik dhe bazen materiale te nevojshme ne perputhje me specifikimet teknike dhe dokumentat e paraqitur ne tender dhe te paraqese certifikatat e cilesise se tyre. Nuk i lejohej qe rolin e sipermarresit t'ia jape nje subjekti tjetër.



- 15
14. Te paraqese tek AK per miratim dhe per te realizur likuidimin e punimeve, Situacion/e te pjeseshm/e per punimet e kryera dhe Situacion Perfundimtar. Situacionet te jene te miratuara edhe nga Mbikqyresi i Punimeve.
 15. Te njoftoje me shkrim AK per daten e perfundimit te punimeve dhe kerkesen per kolaudimin dhe marrjen ne dorezim te Objektivit. Ky njoftim duhet te behet jo me vone se **5 (pese)** dite para dates se perfundimit te punimeve.
 16. Defektet e konstatuara gjate procesit te kolaudimit dokumentohen dhe nga kolaudatori lihen detyra dhe afate me shkrim per ndreqjen e tyre, keto kosto do te perballohen nga Kontraktori.
 17. Kontraktori mban pergjegjesi dhe perballon rreziquet per demtimin dhe humbjen e materjaleve dhe prones publike e private te te treteve, plagosjen, demtimin apo vdekjen e punonjesve te tij apo personave te trete nga mosrespektimi i rregullave te sigurimit teknik etj. Kontraktori mban pergjegjesi per zbatimin e akteve ligjore e nenligjore ne fushen e ndertimeve.
 18. T'i paraqese Mbikqyresit te Punimeve dhe Kolaudatorit te gjithe dokumentacionin shkresor te perditesuar dhe perfundimtar, si dhe certifikatat e provave te perdorura ne Objekt, te cilet mbas verifikimit dhe pranimit i administrojne ne dosjen e Objektivit.

IV. TE TJERA

1. Menyra e komunikimit midis paleve do te jete vetem me shkrim. Bashkia Fier ne baze te Kontrates se bashkpunimit dhe Prokures se Posacme te Bashkimit te Perkohshem te ketyre shoqerive njeh dhe mban kontakte me perfaqesuesin e autorizuar te ketij bashkimi, shoqerine "**Agbes Konstruksion**" shpk Fier.
2. Secila anetare e ketij bashkimi te perkohshem shoqerish merr persiper te gjitha pergjegjesitë dhe detyrimet perpara Bashkise Fier si veç e veç ashtu edhe bashkarisht (detyrim solidar), si persa i perket cilesise se punimeve, afatit te kryerjes se tyre dhe çdo pergjegjesie tjeter te ligjshme qe do te rrjedhe nga kjo kontrate Sipermarrje, bazuar ne nenin 431 te Kodit Civil te R.SH.
3. Per çdo çeshtje qe lind gjate zhvillimit te punimeve, midis paleve kryhen negociata per zgjidhjen e tyre.
4. Ne qofte se Kontraktori braktis Objektivin pa e perfunduar ate, duke zgjidhur Kontraten ne menyre te njeanshme, Ai detyrohet te paguaj demin qe i shkakton Bashkise Fier dhe Garancine e Kontrates.
5. Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfunduara do të bëhen pronë e Autoritetit Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim të kushteve të saj.
6. Palet nuk çlirohen nga cdo pergjegjesi per mos zbatimin e termave te kesaj e Kontrate, pervec se ne rast te veprimet te forcave madhore te vertetuara nga Institucionet Zyrtare.
7. Kontraktori, Mbikqyresi i punimeve dhe Kolaudatori jane te detyruar te kontaktojne zyrtarisht me Specialistin e Investimeve prane Drejtorise se Pergjithshme te Sherbimeve Publike te Bashkise Fier, pasi ky i fundit do te jete personi i kontaktit i cili do te monitoroje gjithe procesin e zbatimit te punimeve, per kete objekt kontrate.
8. Per cdo dite vonese tej afatit te punimeve, Kontraktori eshte i detyruar t'i paguaj Investitorit, **gjobe ne masen 4/1000** të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.
9. Shperblimi per demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamaten e arritur nga data e fillimit te vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bere llogaritja e tyre.
10. Veprimet financiare per llogari te kesaj Kontrate do te kryhen me shoqerine qe perfaqeson bashkimin e perkohshem ne Banken Credin Bank (dega Fier), ne nr. e llogarise Nr.137417 te Sipermarresit.
11. Çdo mosmarveshje qe do te linde gjate zbatimit te kesaj Kontrate, palet do ti zgjidhin me mirekuptim, ne te kundert do t'i drejtohen Gjykates se Rrethit Fier.
12. Pjese perberse e kesaj Kontrate jane edhe Projekti i Zbatimit dhe Preventivi i Zbatimit me cmime qe eshte paraqitur ne tender nga Sipermarresi si dhe Specifikimet Teknike te punimeve te pranuar dhe Grafiku i Punimeve.
13. Çertifikata e Garancise se Punimeve leshohet pas perfunimit te Afatit te Garancise qe eshte **24 muaj**, pasi Kontraktori, Mbikqyresi, Kolaudatori dhe AK kane inspektuar Objektivin dhe kane konstatuar qe nuk ka difekte dhe punime te pakryera si dhe qe ai funksionon ne perputhje me Projektin.
14. Per difektet qe nuk jane ndrequr gjate Afatit te Garancise se punimeve te ndertimit, AK llogarit koston e ndreqjes se tyre dhe bene ndalesen nga vlere e Garancise se punimeve qe eshte ne masen **5%** te vleres totale te Kontrates.
15. Çmimet e punimeve do te jene ato te fituara ne tender, sipas preventivit të paraqitur nga Sipermarresi.
16. Bashkia Fier mund te beje ne çdo kohe porosi tek Kontraktori per te bere ndryshime (specifikime teknike) brenda qelimit te pergjithshem te kontrates.



- 17. Kontraktori është i detyruar që të njoftojë dhe të rakordojë përpara, në vazhdim dhe në përfundim të punimeve me KESH, ALBTELEKOM, UJESJELLES-KANALIZIM sh.a për zgjidhjen bashkarisht të problemeve të infrastruktures së tyre, që të jenë prezente me specialistet e tyre kur do të kryhen punime të cilat kanë të bëjnë me proceset teknike-specifike apo me levizjet e materialeve ose objekteve të cilat janë ekskluzivitet i subjekteve të mesipërme. Afati i njoftimit për këto subjekte do të jetë 5 (pese) ditë përpara kryerjes së punimeve.
- 18. Kjo Kontratë hartohet në 6 kopje, 1 për Kontraktorin dhe 5 për Bashkinë e Fierit dhe pasi lexohet nga palet, nënshkruhet prej tyre me vullnet të lirë në Fier sot me datë 07/03/2016.

Adresa :

Bashkia e Fierit, L. "Kastriot", Rr. "Brigada e XI Sulmuese"
Rr. "Jani Bakalli" Fier
Tel/Fax : 034 22 25 87 www.bashkiafier.gov.al

Adresa :

"Agbes Konstruksion" shpk: Sheq i Madh
Fier

Për dhe në emër të :

Për dhe në emër të :

**AUTORITETIT KONTRAKTOR
BASHKIA FIER**

**KONTRAKTORI
"AGBES KONSTRUKSION" shpk**

Armando SUBASHI
KRYETAR I BASHKISE

z. Arben GOGA
PËRFAQËSUESI LEGJOR

